


Visegad 4 dhe vendet e Ballkanit

të punojmë së bashku për
zhvillimin e efijencës së
burimeve



Autorët:

Ermelinda Mahmutaj (Qendra EDEN, Shqipëri)

Ana Colovic Lesoska (Eko-svest, Maqedoni)

Jelena Vukelić (Qendra për Mjedis, Bosnia dheHerzegovina)

Bjanka Cuturilo (CEKOR, Serbia)

Bankwatch është mirënjohës edhe donatorëve të mëposhtëm për mbështetjen e vazhdueshme të punës sonë: Charles Stewart Mott Foundation, European Climate Foundation, Fondi Ndërkombëtar të Vishegradit, Sigrid Rausing Trust

Ky publikim është përgatitur nga Rrjeti CEE Bankwatch.

Për më shumë informacion kontaktoni



Misioni i rrjetit CEE Bankwatch është të parandalojë ndikimet e dëmshme mjedisore dhe sociale të financimeve ndërkombëtare të zhvillimit; si dhe të promovojë zgjidhjet alternative dhe pjesmarrjen e publikut.

Ky publikim është mundësuar falë mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian dhe Fondit Ndërkombëtar Vishegrad



Hyrje

Në raportet e tij progresive të 2014 për vendet e Ballkanit Perëndimor, Komisioni Evropian shkruan: “Një shoqëri civile e fuqizuar është një komponent i rëndësishëm i çdo sistemi demokratik dhe duhet të njihet dhe trajtohet si e tillë nga qeveria” Në vëmendje të kësaj, Rrjeti CEE Bankwatch - së bashku me partnerët nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Republika Çeke, Hungaria, Maqedonia, Serbia dhe Sllovakia - ka organizuar një seri partneritetesh për një pjesëmarrje aktive të OSHC-ve në këto vende, për ti dhënë formë financimit të BE drejt projekteve dhe programeve të efikasitetit të energjisë. Projekti “V4 dhe Ballkani – punojmë së bashku për zhvillimin eficient të burimeve” zgjati 18 muaj përgjatë 2013 dhe 2014.

Në katër vitet e fundit, Bankwatch ka investuar përpjekje të rëndësishme në ndërtimin e kapaciteteve të OSHC-ve në Ballkanin Perëndimor mbi tematika të ndryshme, veçanërisht në fonde të para-anëtarësimit. Financimi nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA) ka për qëllim të ndihmojë vendet që ndërmarrin reformat e duhura politike, ekonomike dhe institucionale, për ti vendosur ato në përputhje me standardet e BE-së, si pjesë e procesit të zgjerimit. Reformat e nevojshme për anëtarësim në BE synojnë të përmirësojnë jetën e qytetarëve në vendet përfituese. Qëllimet kryesore të kësaj ndihme përfshijnë mbështetje për reformat politike, në veçanti ngritjen institucionale, forcimin e sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut, mbrojtjes së minoriteteve dhe zhvillimin e shoqërisë civile. Bankwatch ka përvujt në orientimin e fondeve të BE në Shtetet e reja Anëtare, dhe ekspertizë të zhvilluar në procesin e zgjerimit dhe anëtarësimit; kjo njohuri i është përcjellë natyrshëm anëtarëve të Bankwatch dhe partnerëve në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në Maqedoni në vitin 2011, nisma u zhvillua si një mënyrë për OShC-të mjedisore për të mësuar në lidhje me IPA dhe procesin e ri të programimit të fondeve të BE-së në vendet e tyre. Në të njëjtin vit u botua i pari udhëzues IPA shumëgjuhësh nga Bankwatch dhe partnerët nga Shqipëria, Maqedonia dhe Serbia i cili u është shpërndarë OSHC-ve në të gjithë rajonin për të ndërtuar njohuri në lidhje me IPA-n. Gjatë vitit 2012 dhe 2013 me ndihmën e Bankwatch OSHC-të nga rajoni u organizuan në procesin e programimit të IPA-s dhe krijuan aleanca për një dialog të mirë me institucionet.

Projekti “V4 dhe Ballkani – punojmë së bashku për zhvillimin eficient të burimeve” fokusohet në

përfshirjen e OSHC-ve në zhvillimin e politikave kombëtare që mund të mundësojnë zbatimin e praktikave të efikasitetit të burimeve. Nëpërmjet një seri praktikash, projekti ndihmoi në shkëmbimin e njohurive gjatë takimeve të përbashkëta me partnerët dhe, në prodhimin e materialeve informative dhe dokumenteve të politikave, duke përfshirë edhe përpilimin aktual të këtij publikimi .

Internshipe janë organizuar për tre partnerë nga Ballkani Perëndimor: Qendra EDEN në Shqipëri kishte praktikën e saj me Miqtë e Tokës CEPA në Sllovakia; CEKOR në Serbi kishte praktikën e tij me Miqtë e Tokës MTVSZ në Hungari; dhe Qendra për Mjedisin në Bosnje & hercegovinë kishte praktikën e saj me Miqtë e Tokës Hnuti Duha në Republikën Çeke. Temat e mbuluara gjatë praktikës realizuan përfshirjen e OSHC-ve në dialog të strukturuar me qeverinë Sllovaqe; nismën mbi ligjet klimatike në Hungari dhe praktikën e menaxhimit të mbetjeve në Republikën Çeke. Tre studimet e paraqitura ofrojnë njohuri në lidhje me përvujt dhe vende të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe analizojnë potencialin për zbatimin e praktikave të mira në vendet e Ballkanit Perëndimor. Përveç kësaj, një studim mbi zbatimin e parimit të partneritetit është përgatitur nga partneri në Maqedoni, si rezultat i angazhimit të tij afatgjatë në proceset e vendimmarrjes në vend.

Kjo përmbledhje ka për qëllim ti shërbejë OSHC-ve në vendet përfituese të IPA-së dhe të sigurojë informacion në lidhje me disa praktika të mira që mund të zbatohen në rajon. Në shprehje të kësaj informacioni të jetë i dobishëm dhe i vlefshëm për tu shpërndarë në të gjithë rajonin.

Ky publikim është prodhuar falë mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian dhe Fondit Ndërkombëtar Vishegrad. Përmbytja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Rrjetit CEE Bankwatch dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet si reflektim i pozitës së Bashkimit Evropian dhe Fondit Ndërkombëtar Vishegrad.

Principet e partneritetit në BE



HYRJE

Parimi i partneritetit në Politikën e Kohezionit supozohet të sigurojë një fazë me një përfshirje të plotë dhe të hershme të të gjitha palëve të interesuara, në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e investimeve të fondeve të BE-së. Të tilla përfshirje dhe angazhime mund të nxisin përfitime të ndryshme dhe vlera të shtuara si përmirësimin e angazhimit kolektiv dhe pronësinë e politikave dhe investimeve të BE-së, duke rritur njohuri, ekspertizë dhe pikëpamje në hartimin e projekteve dhe përzgjedhjen dhe zbatimin efikas të projektit, si dhe duke siguruar transparencë më të madhe në proceset e vendim-marrëse dhe parandalimin e mashtrimit dhe keqpërdorimit të parave të taksapaguesve.

Propozimi i Komisionit Evropian për legjislacionin e ri të Politikës të Kohezionit përcaktohet, në artikullin 5 të Rregullores së Partneritetit” (ECCP-ja). Kjo, e përcaktuar nëpërmjet një akti të deleguar dhe miratuar nga Komisioni Evropian në janar 2014, duhet tu japë udhëzime shteteve anëtare dhe të promovojë praktikatat më të mira në fushën e partneritetit në lidhje me: përfshirjen e partnerëve dhe dialogun me vendimmarrësit; procesin e përzgjedhjes së tyre; aksesin në informacione, në afatet kohore dhe dokumentet e planifikimit; raportimin për konsultim dhe rolet e partnerëve dhe vlerat e shtuara gjatë programimit; si dhe fleksibilitetin në procedura specifike, kombinuar me përgjegjësitë për të siguruar një proces transparent dhe pjesëmarrës (duke përfshirë raportimin e veprimeve të ndërmarra në këtë drejtim). Kështu ajo synon të adresojë një nga dobësitë kryesore të zbatimit aktual të parimit të partneritetit - praktikatat e ndryshme dhe cilësitë e përfshirjes në vende të ndryshme anëtare, duke çuar shpesh në partneritete me standarte të ulëta. Gjatë negociatave mbi kuadrin ligjor, shtetet anëtare ishin të suksesshme në parandalimin e çdo kërkesë të detyrueshme ose standartet minimale të detyrueshme, ata do të duhet të përmbahen aq kohë sa ka të bëjë me partneritetin. Falë presionit nga shtetet anëtare, i gjithë parimi i partneritetit –

krahasuar me propozimin fillestar të Komisionit – është përpunuar dhe tashmë është subjekti i “fleksibilitetit të plotë”, duke lejuar kështu sa më shumë të jetë e mundur “udhëheqje të mirë” sikundër është parë e arsyeshme nga këndvështrimi i ministrave të përfshirë.

Vendet anëtare të angazhuara “ndërkohë në fazën përgatitore të dokumentave të programimit për të marrë në konsideratë sa më shumë që të jetë e mundur principet e projekt rregullores” për shembull duke përfshirë elementët kryesorë të parimeve të partneritetit. Në shkurt 2013, Rrjeti CEE Bankwatch dhe partnerët e tij paraqitën një pikëpamje pozitive në aplikimin e parimeve të partneritetit që në fillimet e procesit të programimit. Afatet kohore dhe procesi i përfshirjes së palëve të interesuara duket sikur u përcaktuan, megjithatë prova e vërtetë e cilësisë së partneritetit ende duhej parë në fazat e para të procesit të programimit, në kohën kur zbatimi i parimeve të partneritetit sapo kishte filluar.

Tashmë, në mars 2014, me dorëzimin e projekt-marrëveshjeve të partneritetit në Komisionin Evropian dhe gjithashtu me përcaktimin e strukturave kryesore dhe prioritetive të programeve operationale në shumicën e vendeve, u bë e qartë që në disa vende të Evropës Qendrore dhe Lindore zbatimi kuptimplot i parimeve të partneritetit mbetet ende një perspektivë e largët.

REALITETI DERI MË TANI

Shtetet anëtare i interpretojnë dhe i zbatojnë parimet e partneritetit në mënyra të ndryshme, me intensitet të ndryshëm. Kështu qe, eksperiencat janë gjithashtu të shumëllojshme shtet më shtet, e cështje më cështje. Gjithsesi kohët e fundit vecanërisht në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, përgjithësisht parimi i partneritetit nuk është zbatuar në atë mënyrë që të arrijë qëllimin

e tij, domethënë në arritjen e një programimi dhe planifikimi gjithëpërfshirës, duke përfshirë nevojat dhe njohuritë nga të gjithë palët e interesuara potencialisht të ndikuara dhe përfshirjen e vazhdueshme të shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes politike si dhe hapjen dhe transparencën në programim dhe prezantim.

CILI ËSHTË QËLLIMI ?

Rritja e angazhimit civil dhe pjesëmarrja e mjedisorëve të interesuar do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë, relevancës dhe efektivitetit të politikave qeveritare dhe të sigurojë që cështjet socialo-mjedisore të jenë të adresuara përkrah cështjeve ekonomike. Një përjasje përfshirëse ka të ngjarë të krijojë më shumë besueshmëri në politikat dhe vendimet, si dhe në institucionet që i zhvillojnë dhe i përcjellin ato.

Vetëm pjesëmarrja publike, transparencja dhe aksesin në informacion mund të garantojë aplikimin e duhur të procedurave të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit si VNM dhe VSM, dhe janë esenciale për lehtësimin e përgjegjshmërisë të procedurave dhe vendimeve politike.

AKSESI I PËRGJITHSHËM PËR INFORMACION

Autoritetet menaxhuese të Politikave Kombëtare të Kohezionit duhen aktivisht ti ofrojnë publikut të gjithë informacionin e nevojshëm për të lejuar një pjesëmarrje të informuar në procesin e vendimmarrjes dhe jo vetëm kur informacioni kërkohet. Ata duhet të publikojnë informacion mbi procedurat e programimit dhe draft-dokumentat si edhe informacion të detajuar për projektet që janë ndërkohë të disponueshme në një nivel kombëtar në kohë të përshtatshme. Kjo duhet të jetë e shoqëruar nga një vlerësim dhe me publikimin e kostos dhe ndikimin e programeve, subvencioneve dhe projekte që ndikojnë jetën e qytetarëve.

Informacioni duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm në kohë në të gjitha nivelet relevante (evropiane, kombëtare dhe rajonale) dhe duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtme: dokumentimi përgatitor përbrenda programimit dhe zbatimit, programet, kriteret dhe proceset për përzgjedhjen e projektit, përbërjen e komitetit përzgjedhës, projekt-propozimet, VNM-të, projektet e përzgjedhura, përfituesit, auditimi, kriteret dhe raportet e monitorimit dhe vlerësimit. Proceset që cojnë në vendime si dhe zbatimi dhe përfundimi i tyre, duhet të jenë të qarta dhe të aksesueshme për të gjithë.

PARTNERITETI NË ZBATIM

- Ndërtimi i kapaciteteve duhet t'i ofrohet palëve të interesuara (përfshirë OJF-të dhe nëpunësit civil, etj.) që të marrin pjesë në proceset e partneritetit (për të kuptuar motivimin e njëri-tjetrit, proceset e brendshme, etj.).
- Mbështetje, konsultim dhe trajnime duhet t'i ofrohen aplikantëve potencial të projekteve për fondet e Politikave të Kohezionit.
- TBE-ja dhe shtetet anëtare duhet të sigurojnë që mbështetja financiare të mund të vihet në dispozicion për përfshirjen e OJF-ve.
- Në rastin e disa masave (p.sh: zhvillimi social, zhvillimi komunitar), bashkëpunimi me OJF-të duhet të jetë një kusht i domosdoshëm për aplikantët.
- Pengesat administrative dhe financiare në qasjen ndaj fondeve të BE-së për OJF-të duhet të reduktohen.
- Autoritetet e shteteve anëtare dhe Komisioni Evropian duhet të publikojnë informacion rreth zbatimit të projekteve si pjesë e kompetencave të tyre në një menyrë koherente në internet.
- Ekspertët e OJF-ve duhet të përfshihen në vlerësimin e projekteve dhe zgjedhjen e skuadrave.
- Kostot e drejtpërdrejta të partnerëve (p.sh udhëtimet) që lidhen me pjesëmarrjen e tyre në planifikim, monitorim, vlerësim të projektit ose struktura të tjera që lidhen me partneritetin duhen rimbursuar.

PARTNERITETI NË MONITORIM

- Qëllimi i kompetencave të komiteve monitoruese duhet të zgjerohet (në kuptimin e adoptimit të ndonjë ndryshimi në dokumentat relevante të programimit dhe zbatimit dhe gjithashtu marrjes me performancën horizontale të programeve).
- Një komitet monitorues që mbikëqyr të gjitha programet operationale në nivel kombëtar duhet të ngrihet.
- Partnerët duhet madje të përfaqësohen në komitetet monitoruese dhe të zgjidhen përmes një procesi transparent që respektohet nga autoritetet.
- OJF-të duhet të përfaqësohen në të gjitha komitetet monitoruese dhe përfaqësuesit e tyre duhet të kenë të drejta vote.
- OJF-të duhet të jenë në gjendje të zgjedhin përfaqësuesit e tyre dhe autoritetet nuk mund të influencojnë këto zgjedhje.
- Nuk duhet të ketë kërkesa ose kushtëzime për përfaqësuesit e OJF-ve të ndryshme nga ato të cdo anëtarit tjetër të komitetit monitorues.

Zyra e plotfuqishme në Sllovaki



STRUKTURA, DETYRAT DHE PERGJEGJSHMERITE KRYESORE

Zyra e plotfuqishme përfaqëson një zyrë të ngritur nga qeveria për të lehtësuar/koordinuar mardhëniet midis organiztave të shoqërisë civile dhe qeverisë, dhe ajo punon në mënyrë sistematike në mbështetje të mekanizmave për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Sllovaki, duke përfshirë ngritjen e bazës ligjore dhe mekanizmave të mbështetjes financiare sikundër janë alokimi i taksave, aksesit në skemat publike të finacimit etj. Ajo përfaqëson një strukturë këshillimore për qeverinë Sllovaqe dhe zyrat janë të vendosura brenda strukturës së institucioneve të qeverisë. Zyrtarisht të gjithë punonjësit janë punonjës shtetërorë por që vijnë nga sektori i shoqërisë civile. Përmasat e zyrës variojnë duke u varuar nga plani për zhvillimin e shoqërisë civile dhe detyrat e përcaktuara. Kjo zyrë ka filluar me dy punonjës dhe tashmë ata janë rreth tetë punonjës. Drejtuesi i zyrës quhet i plotfuqishmi.

Puna e të Plotfuqishmit dhe zyra e saj/tij bazohet në një statut në të cilin përcaktohen detyrat kryesore. Statuti është zhvilluar nga një grup pune me përfaqësues të shoqërisë civile. I Plotfuqishmi cokatohet dhe largohet nga qeveria me propozim të Kryeministrit dhe është i përgjigjshëm ndaj qeverisë. I Plotfuqishmi menaxhon, drejton dhe kontrollon ecurinë e punës së zyrës.

Një nga detyrat kryesore ka qenë hartëzimi i problemeve dhe mjedisi ku vepron sektori i shoqërisë civile, më pas u ngrit një bazë për komunikimin midis shtetit dhe sektorit. Detyra të tjera më pas u caktuan përfshirja e përfaqësuesve të OSHC në procesin e vendimarrjes i cili nisi

si rezultat i zhvillimit të një plani afatgjatë për zhvillimin e shoqërisë civile duke përfshirë edhe modelet për mbështetjen e tij.

Shpenzimet e lidhura me performancën dhe detyrat e të plotfuqishmit janë të mbështetura nga buxheti i shtetit dhe drafti për buxhetin e zyrës së plotfuqishme dorëzohet si pjesë e zërit të buxhetit për zyrën qeveritare.


I Plotfuqishmi konsiderohet si një person i cili merr pjesë në konsultimet ndër-ministrale. Në rastet ku cdo material që ka të bëjë me pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, shoqërinë civile që është e përgjegjshme për aktivizimin e qytetarëve dhe/ose finacimim në zona të caktuara, dhe/ose alokimin e fondeve nga fondet e huaja dhe Bashkimi Evropian në republikën e Sllovakisë etc. dorëzohet për konsultim ndër-ministral nga anga autoritetet qeveritare administrative, i plotfuqishmi është personi të cilit ky material duhet ti dorëzohet për qëllime konsultuese në përputhje me rregulloren legislative të qeverisë Sllovaqe.

I plotfuqishmi merr pjesë në sesionet qeveritare të cilat janë në sektorin e tij të punës dhe dorëzon propozime për diskutime të institucioneve të cilëtkanë një rol këshillues për qeverinë. Ai/Ajo punon së bashku me autoritete manaxhuese të programeve relevante operationale për periudhën e programimit 2007 – 2013 dhe 2014 – 2020.

Një bashkëpunim ...



&



DETYRAT E PËRGJEGJSHMËRITË KRYESORE TË TË PLOTFUQISHMIT

Brenda detyrave dhe përgjegjshmërive të tij i plotfuqishmi në vecanti duhet të :

1. Të sigurojë dhe koordinojë hartimin e një plani afatgjatë zhvillimi për shoqërinë civile në Sllovaki për periudhën 2012 – 2022, i cili kërkon fuqizim të qytetarëve kundër shtetit dhe autoriteteve të tij si dhe mbështet cdo aksion të nisur nga qytetarët për rritjen e pjesmarrjes së tyre dhe influencës aktive në politikbërjen shtetërore;
2. Të sigurojë dhe koordinojë processin e zhvillimit të një strategjie afatmesme për rritjen e pjesmarrjes qytetare dhe zhvillimin e sektorit jo qeveritar dhe jo fitimprurës për vitin 2012 – 2016;
3. Të sigurojë dhe koordinojë procesin e rritjes së efektivitetit të kushteve të zhvillimit të shoqërisë civile në Sllovaki duke i kushtuar vëmendje:
 - a. Pjesmarrjes aktive të qytetarëve dhe shoqërisë civile në monitorimin e fondeve të bashkimit Evropian si dhe programimim e periudhës tjetër për zbatimin e programeve operationale në mënyrë që të sigurojë që organizatat e shoqërisë civile janë midis përfituesve kryesorë të kësja asistence,
 - b. Mbështetjes së infrastrukturës së shoqërisë civile nëpërmjet ministrive të vecanta,
 - c. Rregullimit të mekanizmave ekzistues për mbështetje të drejtëpërdrejtë financiare dhe asaj jo të drejtëpërdrejtë nga fondet publike për shoqërinë civile për të siguruar që organizatat e shoqërisë civile i marrin dhe i përdorin këto fonde në mënyrë efektive dhe transparente sa më shpejt të jetë e mundur,
4. I Plotfuqishmi ka gjithashtu përgjegjësi në procesin e hartimit dhe të zbatimit të planeve:
 - a. Monitoron, analizon dhe vlerëson cilësinë e komunikimit në nivelin e partenritetit, mundësitë e pjesmarrjes së drejtëpërdrejtë, diskutimet me publikun dhe konsiderimet e publikut për zgjidhje,
 - b. Koordinon procesin e rritjes së efektivitetit të kushteve për zhvillimin e komunikimit në një nivel partneriteti, diskutimet publike duke marrë në konsideratë:
 - i. Amendimet në rregulloret për të siguruar që këto stimulojnë pjesmarrjen publike në rregulloret ligjore,
 - ii. Rishikimet e komunikimeve aktuale me publikun me qëllimin e miratimit të masave për të siguruar komunikim të hapur dhe pjesmarrjen e publikut në procesin e vendimarrjes,
 - c. Merr pjesë në procesin legjislativ i cili rrjedh nga strategjia afat-mesme për rritjen e pjesmarrjes së qytetarëve dhe zhvillimin e sektorit jo qeveritar dhe jo fitimprurës,
 - d. Në bashkëpunim me shoqërinë civile, monitoron, analizon dhe vlerëson cdo problem që lidhet me caktimin e një mjedisi dhe kushteve optimale për zhvillimin dhe punën e qendrushme të shoqërisë civile,
 - e. Promovon zhvillimin e një komunikimi efektiv midis sektorit publik dhe shoqërisë civile,
 - f. Siguron dhe ndërmerr aktivitete të tjera të deleguara tek ai/ajo nga qeveria

ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË NXITJEN E PROCESIT

Procesi filloi si një nismë e Kryeministrit të mëparshëm Sllovak, Iveta Radičová, i cili kishte lidhje të mira me shoqërinë civile dhe sektorët akademik së bashku me personalitete kyç të shoqërisë civile, aktivë në jetën politike, të cilët kishin një opinion të fortë në lidhje me funksionimin brenda sektorit dhe në një farë mase edhe publikun e gjerë. Procesi nisi formalisht nëpërmjet Këshillit Qeveritar për shoqërinë civile.

Zyra filloi veprimtarinë e saj në vitin 2010 dhe në vitin 2011 ajo rigjallëroi traditën e konferencave të shoqërisë civile. Konferenca e vitit 2011 u fokusua

në vendosjen e mardhënieve të qarta dhe të kuptueshme midis sektorit të shoqërisë civile dhe zyrës së re të porsahapur, si dhe në përcaktimin e prioriteteve kyç për aktivitetet e kësaj zyre, detyrat dhe qëllimet. Kjo çoi në zhvillimin e një plani për zhvillimin e shoqërisë civile i cili u shndërrua në programin kryesor të të plotfuqishmit dhe zyrës së tij. Programi u mbyll në vitin 2013. Programi i ri nuk është hartuar ende pasi si rezultat i ndryshimeve ne qeveri iplotfuqishmi dha dorëheqjen. Aktualisht është duke u menduar zëvendësimi apo mënyrat alternative të veprimtarisë së zyrës së plotfuqishme.

ROLI I KËSHILLIT QEVERTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Ky këshill përfaqëson forumin e vetëm formal në të cilin përfaqësuesit e shtetit dhe shoqërisë civile takohen. Si rezultat i punës së të plotfuqishmit puna e këtij këshilli është ripërcaktuar për të lejuar funksionimin e pavaruar madje edhe në mungesë të pjesëmarrjes së përfaqësuesve të palës shtetërore, gjë që ka rritur aftësinë e tij për të vepruar. Është një model me dy dhoma, dhoma e shoqërisë civile

dhe shoma e qeverisë. Dhoma e shoqërisë civile ka të drejtën të përcaktojë detyra dhe të kërkojë veprim nga qeveria kur përfaqësuesit e saj bien në një mendje dhe mund të ngrënë një kërkesë të përbashkët. Pas kësaj qeveria ka të drejtën të veprojë. Kjo ka ndihmuar në presionimin e administratës qeveritare të veprojë.

PARALELIZËM ME SITUATËN AKTUALE NË SHQIPËRI

Organizatata e regjistruara në Shqipëri në total janë 1858, të cilat duke u bazuar në vlerësimet e TACSO vetem 450 janë aktive. Ndër këto organizata vetëm 70 prej tyre janë organizata mjedisore sipas vlerësimeve të REC Shqipëri. Atmosfera e punës i këtij sektori jo-qeveritar, jo-fitimprurës është shumë i vështirë dhe me mundësi të pakta. Më fjalë të pakta mund të themi që në termat e legjislacionit fiskal në Shqipëri sektori trajtohet i barabartë me sektorin e biznesit.

Gjatë tre dekadave të fundit, përfshirja e sektorit dhe e pranisë në çështjet publike ka qenë gjithmonë e më shumë e dukshme. Presioni i tij në luftën kundër korrupsionit, në çështje të ndjeshme që prekin jetën e publikut, në lobimin për përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në politikë dhe vendimarrje, në nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave e grupeve të marginalizuara, në luftën për mbrojtjen e mjedisit

etj. Kjo përfshirje është cilësuar si një hap pozitiv për të ndikuar në ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe për të nxitur përfshirjen e qytetarëve për më shumë pjesëmarrje në procesin vendimarrës dhe politikë në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes. Përveç mjaft arritjeve ka një mungesë të procedurave standarte dhe mekanizmave që mundësojnë një pjesëmarrje efektive dhe në kohë të OJF-ve në vendimarrje dhe politikë bërje në linjë me standardet ndëkombëtare dhe praktikata më të mira.

Marrëdhëniet ndërmjet qeverisë dhe OJF-ve janë sporadike dhe sipërfaqësore, më shumë në një nivel informativ dhe si rezultat i paefektshëm, duke u karakterizuar nga mungesa e procedurave standarde dhe rregullave të detyrueshme për t'u angazhuar në një dialog të kuptimtë dhe në kohë me shoqërinë civile. Shteti nuk e njeht plotësisht rëndësinë e sektorit të OJF-ve dhe zhvillimin e tij, si një partner

të pa zëvendësueshëm në mirëqeverisje, përparimin e demokracisë dhe një zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik në vend. Bashkëpunim dhe partneriteti ndërmjet OJF-ve dhe qeverisë Shqiptare, është e një rëndësie të madhe dhe duhet të konsiderohet si një çështje parësore për zhvillimin e dyantë, jo vetëm si një kërkesë e Bashkimit European që duhet të plotësohet për procesin e integritimit.

Për shkak të mungesës së një strategjie kombëtare për zhvillimin e sektori të OJF-ve në Shqipëri, si dhe mungesa e koordinimit ndërmjet OJF-ve, shtetit dhe komunitetit të donatorëve sjell si pasojë një sektor të brishtë, jo të qëndrueshëm dhe me një imazh të dobët në publikut.

Është thelbësore patja e një strukture ligjore dhe rregullatore si e vendeve të tjera, për një zhvillim të qëndrueshëm të një sektori aktiv OJF-sh në Shqipëri. Duke patur parasysh kritere të ndryshme që kjo strukturë mund të ndihmojë si: në krijimin e procedurave dhe rregullave për regjistrim më të thjeshta, më transparente dhe më me kosto të ulët; mbrojtje nga ndërhyrjet qeveritare dhe/ose drejtimet në funksionet e pavarura të OJF-ve, krijimin e bazave të nevojshem ligjore dhe praktike për tu anagzhuar në aktivitete për ngritjen e fondeve dhe për të legjitimuar aktivitete e gjenerimit të të ardhurave., rritja e aksesit në informimit dhe në vendimmarje, vendosjen dhe ekzekutimin e taksave të qarta për procedurat e prokurimit dhe njohjes së diferencës ndërmjet sektorit jo fitimprurës dhe privat, krijimin e mekanizmave shtetërorë që mbështesin qëndrueshmërinë dhe efektshmërinë e OJF-ve, etj. Mund të përmyllet që ka ende mjaft përpjekje për t'u bërë në Shqipëri për një strukturë të përshtatshme ligjore dhe praktike për OJF-të, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe European.

Qeveria e re në Shqipëri, që ka filluar qeverisjen në vend në shtator 2014 është shprehur hapur në lidhje me rishikimin dhe miratimin e Kartës për Shoqërinë Civile në parlamentin Shqiptar në vitin 2014 dhe për themelimin e një këshillit kombëtar të OJF-ve si forumi që instituanilizon marrëdhënien ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë Civile. Gjithashtu qeveria shqiptare ka nënshkruar Partneritetin për një Qeveri të Hapur dhe procesi po ndodh pa një përfshirje të madhe të shoqërisë civile, ose dhe nëse ka përfshirje nuk është përfaqësuese.

Në mënyrë për të lehtësuar dhe nxitur këto veprime, në dhjetor të vitit 2013 OJF-të në vend organizuan një aktivitet si rezultat i të cilit doli një deklaratë publike për qeverinë për të përqsuar një dialog dhe për të nisur procesin e bashkëpunimit.

PËRFUNDIME

Duke u prezantuar me formën e organizimit dhe përfaqësimit zyrtar të shoqërisë civile në vendimarrje në Sllovak, por gjithashtu mjedisi mundësues i krijuar për punën e shoqërisë civile, duke e krahasuar me situatën aktuale në Shqipëri kemi nxjerrë disa përfundime të cilat duam ti prezantojmë:

- Tani është momenti dhe atmosfera e duhur politike për të organizuar shoqërinë civile në vend, me vëmendje specifike sektorit të mjedistit i cili është më pak i përfshirë në zhvillimet e fundit, në mënyrë që të fillojë dialogu me qeverinë duke patur në zotërim modelin Sllovak.
- Një organizatë udhëheqëse nevojitet të koordinojë procesin e aktivizimit të shoqërisë civile. Qendra EDEN shpreh gadishmëri të ndërmarrë këtë udhëheqje dhe do të përpiqet të organizojë një tryezë të rrubullakët midis organizatave mjedisore si dhe takime të ndryshme me sektorë të ndryshëm të shoqërisë civile në mënyrë që të prezantojë Modelin Sllovak dhe rolin e shoqërisë sllovaqe në këtë model.
- Grupi i punës së organizatave të interesuara të përfshihen dhe të jenë aktive në proces sugjerohet të punojë fort në mënyrë që të përshtasë modelin sllovak në realitetin shqiptar për ta prezantuar atë tek qeveria shqiptare.
- Një grup organizatash nga shoqëria civile duhet të jetë aktiv në monitorimin e vendimarrjes në nivelin e Parlamentit në të cilin së shpejti do të diskutohet Karta e Shoqërisë Civile në Shqipëri.
- Sektori i shoqërisë civile në Shqipëri duhet të konsolidohet dhe të punojë me standard të përmirësuar, të koordinojë përfaqësinë e tij në publik dhe të forcojë presionin për një proces vendimarrjeje gjithëpërfshirës dhe transparent sidomos në vendimarrjen mjedisore.
- Shoqëria civile në Shqipëri duhet të presionojë në mënyrë më proaktive për përfshirjen e saj në procesin e programimit (IPA II), si dhe Qeveria dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri duhet të përpqen më shumë në realizimin e një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës. Ky bashkëpunim do të krijojë baza për një dialog të hapur midis aktorëve të mësipërm, për një kulturë punë së bashku dhe mbështetëse duke zhdukur ndjenjat e mosbesimit. Duhet të konsiderohet si një hap i parë drejt hapjes së zyrës së plotfuqishme në Shqipëri.

REFERENCA

- Matrica e Monitorimit për një mjedis mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile – raporti kombëtar: Partners Albania Center for Change and Conflict Management, ISBN 978 – 9928 – 08 – 141 – 4;
- Statuti i të Plotfuqishmit të Qeverisë Sllovaqe për zhvillimin e shoqërisë civile;
- Rezoluta e Republikës Sllovaqe N. 68 nga 22 shkurt 2012
- Plani i Veprimit për Partneritet për Qeveri të Hapur i Republikës Sllovaqe

Ndryshimet klimatike – efiçenca e energjisë



Mbrojtja e klimës dhe shoqëria e qëndrueshme janë padyshim të lidhura me njëra tjetrën, klima përcakton kushtet ekologjike për ekzistencën e biodiversitetit, dhe të dyja së bashku përcaktojnë kushtet për ekzistencën e shoqërisë. Përveç kësaj,

shoqëritë e qëndrueshme e kanë të nevojshme të sigurojnë që qëniet njerëzore mos të shkaktojnë ndryshime mjedisore ndaj të cilave e kanë të vështirë për tu përshtatur.

NË HUNGARI

Në vitin 2009 juristë nga Austria, Republika Çeke, Estonia, Hungaria dhe Slovenia kanë monitoruar zhvillimin e legjislacionit mbi çështjet e ndryshimeve klimatike. Bazuar në këto raporte ka disa ligje në shtetet anëtare , për të siguruar arritjen e objektivave për zvogëlimin e çlirimeve sipas Konventës së Kiotos (2012).

Megjithatë, raporti Austriak dhe Slloven deklarojnë që masat e ndërmarra në vend, bazuar në ligjet ekzistuese, nuk do të jenë të mjaftueshme për të përmbushur angazhimet ndërkombëtare që kanë pranuar. Estonia, Republika Çeke dhe Hungaria nuk do të kenë probleme serioze në arritjen e zvogëlimit të nivelit të synuar për vitin 2012, por të tre raportet vënë në pah që kjo vjen si pasojë e ndryshimeve në industri dhe ekonomi të shkaktuara nga ndryshimet politike në fillim të viteve 1990.

Parlamenti Hungarez miratoi Rezolutën nr.60 të vitit 2009 (24 qershor) në përgatitjen e një struktur-dekreti për Mbrojtjen e Klimës më 24 qershor 2009, i cili në këtë fazë në të vërtetë është një angazhim politik dhe jo një ligj. Sipas rezolutës, draft i strukturës së dekretit (Kostoja e klimës) i është dorëzuar parlamentit në Shkurt të 2010, por si pasojë e ndryshimeve në çastet e fundit të ndikuara nga industria e lëndëve djegëse, debatet parlamentare kaluan kohën e përcaktuar duke mos arritur në një përfundim. Parlamenti i ri, pavarësisht punës lobuese të MTVSZ (Friends of the Earth Hungari), ende nuk e ka vendosur në programin e tij diskutimin për draft dekretin. Në Hungari rezoluta parlamentare deklaroi që dekreti i ardhshëm, duhet të përcaktojë detyrat që kanë lidhje me kërkimin dhe zhvillimin në lidhje me çështjen e ndryshimeve klimatike.

Nevoja për një grup instrumentësh rregullatorë gjithëpërfshirës u ngrit si çështje në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe në Strategjinë Kombëtare Klimatike të Hungarisë. Megjithatë, reforma e vërtetë është shtyrë gjithmonë. Ajo ose nuk është diskutuar apo zhvilluar, ose ambiciet për të janë hedhur poshtë duke u bazuar në atë që Hungaria nuk do të jetë në gjendje për të futur e vetme një sistem të tillë në skenën globale. Në të njëjtën kohë është bërë e qartë që tregu nuk mund të zgjidhi çështjet për të ardhmen bazuar në funksionin e tij aktual. Reagimi për reduktimin e karburëve fosile ose të ndryshimeve klimatike duhet të formulohet të paktën dhjetë ose njëzet vjet përpara¹.

Në Hungari për shkak të tranzicionit ekonomik disa tipe të ndikimeve në mjedis, duke përfshirë çlirimet e gazeve serrë, kanë rënë në mënyrë të ndjeshme. Në vitin 2009 kjo është shoqëruar me një reduktim tjetër të rëndësishëm për shkak të rënies ekonomike.

- Hungaria ka përafërsisht 10 % energji të rinovueshme. OJF-të synojnë të arrijnë 19% deri në vitin 2020 dhe 29% deri në vitin 2030 (në përqindje / energji bazë e përdorur). Objektivi zyrtar për vitin 2020 është 14.65%.


- Efiçenca e energjisë me afërsisht 80% të varfërisë energjitike të 90% shtëpive nuk është e mirë izoluar. Varfëria energjitike – janë zbatuar disa projekte në ndërtesa, por jo në shtëpi individuale.

- Popullsia nuk investon mjaftueshëm në eficienten energjitike (izolim) sepse faturat e energjisë elektrike janë ulur tashmë (në mënyrë artificiale nga shteti) dhe mungesa e kapitalit të tyre kështu

Një bashkëpunim midis



&



që nuk janë të motivuar për të investuar. Në 2007, 40.6% e energjisë totale në përdorim në Hungari ishte e lidhur me shtëpitë, 21.3% ishte e lidhur me sektorin komunal dhe 27.5% me trafikun dhe transportin. Më shumë se gjysma e energjisë në përdorim nga shtëpitë shkon për ngrohje dhe më tej një e treta për përdorim të makinave. Në të njetën kohë, banesat janë përgjegjëse për afërsisht një të tretën e çlirimeve

Strategjia për Ndryshimet Klimatike është zhvilluar në vitin 2006, ku MTVSZ ishte pjesërisht i përfshirë (MTVSZ organizoi një fushatë kombëtare për rritjen e ndërgjegjësimit për këtë strategji dhe disa nga rekomandimet e saj janë përfshirë në Strategjinë),

NË SERBI

KORNIZA NDËRKOMBËTARE DHE DETYRIMET NË SERBI

Republika Serbe ka qenë palë e konventës që nga 10 qershor 2001 dhe e protokollit të Kiotos që nga 17 janar 2008, si një vend në zhvillim (tek – Shtojca I Palët). Përgjatë procesit të hartimit të Komunikimit Kombëtar fillestar u vu re që problemi i ndryshimit të klimës u shndërrua në objekt të interesave të gjera vetëm përgjatë viteve të fundit.

Harmonizimi i legjislacionit vendas me akis të BE në fushën e ndryshimeve klimatike përfshin transpozimin e paketës së BE për klimën dhe energjinë. Një nga direktivat më kërkuese është direktiva e BE-së për Sistemin Tregtar të Çlirimeve (ETS BE). Përgatitja dhe zbatueshmëria e kësaj direktive nënkupton krijimin dhe forcimin e kapaciteteve legjislative dhe institucionale si dhe të industrisë, në mënyrë që të plotësohen kërkesat e monitorimit dhe raportimit².

Rëndësia e përcaktimit të Veprimeve Kombëtare të Përshatshme Mitiguese është e reflektuar në gatishmërinë e vendit për kufizimin e çlirimeve dhe në zhvillimin ekonomik që duhet të realizohet në të njëjtën linjë me kapacitetet vetjake dhe mundësitë,

Ministria ka kërkuar reagim nga grupet e interesit. Legjislacioni i klimës u prezantua me qëllimin ambicioz që është një qasje e mirë për zvogëlimin e ndryshimeve klimatike, por zbatimi ishte i dobët. Pas qeverisë së re një strategji e re ishte e përgatitur, por MTVSZ nuk ishte në gjendje të merrte vetë pjesë në përgatitjen e strategjisë, por pati mundësinë për të komentuar mbi versionin përfundimtar. Sipas mendimit të organizatës strategjia e re është më e dobët se strategjinë e mëparshme, kryesisht për shkak të ndërtimit apo zgjerimit të centraleve bërthamore. Ndërgjegjësimi ndaj ndryshimeve klimatike dhe ndikimi ndaj rritjes janë mundësi reale në zbatimin e fushatës.

si dhe në përputhje me parimet e një zhvillimi të qëndrueshëm. Në këtë mënyrë mundësitë për të financuar në nivel ndërkombëtar janë në rritje dhe zbatimi i veprimeve specifike janë të rëndësishme për vendin.

Në mënyrë që marrëveshjet ndërkombëtare dhe rajonale të zbatohen, kërkohet një harmonizim dhe zhvillim paralel i bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe rajonale, miratim i dokumentave strategjike, ndërtim i një legjislacioni modern, vazhdimësi politikash në lidhje me dokumentat strategjike dhe zbatueshmërinë e tyre, zbatim i ligjeve dhe rregulloreve që zbatohen për institucionet përkatëse, burime njerëzore dhe partneritet me palët e interesuara. Gjithashtu, është thelbësore për marrëdhëniet ndërkombëtare sigurimi i fondeve për të gjitha këto aktivitete.

Nëse qeveria nuk është në gjendje që të përballet me ndryshimet klimatike kjo mund të shkaktojë crregullim të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe një pozicionim jo të mirë kundrejt integritimit European.

PËRBËRJA INSTITUCIONALE NË SERBI NË FUSHËN E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Serbia nuk ka një strukturë institucionale të qëndrueshme. Zyra për ndryshimet klimatike është duke u themeluar dhe financuar në kuadër të projekteve ndërkombëtare dhe jo nëpërmjet buxhetit të Serbisë. Në këtë mënyrë ministria ka staf me nën- kapacitet për t'u marrë më çështjen e ndryshimeve klimatike.

Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave për klimën dhe ndotjen e ajrit në Republikën Serbe, është kryer nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, në përputhje me dispozitat ligjore, që gjithashtu udhëheq Regjistrin Kombëtar të burimeve ndotëseve.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit ka ngritur në Republikën Serbe një monitorim automatik të cilësisë së ajrit (me intensitet të ndryshueshëm, në periudhën 2006-2010), nëpërmjet projektit „FURNIZIMI ME PAJISJE PËR STACIONE MONITORUESE TË AJRIT, SERBI“ EUROPEAID/124394/D/SUP/YU)

Gjatë vitit 2012 vështirësitë e hasura ishin në zbatueshmërinë e aktiviteteve të planifikuara në fushën e mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve në

rrjetet kombëtare të stacioneve automatike që masin cilësinë e ajrit, dhe shkaqet e vështirësive janë të natyrës financiare. Pasojat u pasqyruan në sigurimin e një numri më të vogël të dhënash në dispozicion, rregulloret e përcaktuara nga volumi vjetor, me qëllim vlerësimin e gjendjes së cilësisë së ajrit, mund të arrijmë në përfundimin që kjo përjasje është e paqëndrueshme.

Në vitin 2013 Serbia filloi përgatitjet për raportin e dytë UNFCC, për ndryshimet klimatike. OJF-të janë të përfshira formalisht. Proçesi është i mbështetur financiarisht nga qeveria e Serbisë dhe UNDP. Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit është pika kryesore për mbledhjen e të dhënave dhe është e pritshme që raporti i dytë i UNFCC do të pranohet zyrtarisht në një sesion qeveritar përafërsisht në Shtator 2014.

Serbia vendosi të fillojë përgatitjen e strategjisë për zbutjen dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike në vitin 2015, në të njëjtën kohë kur ajo do të përgatiste planin e veprimit të financimit IPA që lidhen me ndryshimet klimatike. OJF-të janë të përfshira në këtë fazë përgatitore. Pritet që plani i veprimit të zbatohet vetëm nga 2016.

SITUATA NE SERBI NË LIDHJE ME EMETIMET DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

Që prej ratifikimit të Konventës së Kiotos (2008) e deri më sot, nuk është bërë një mbledhje e përkushtuar dhe sistematike e të dhënave mbi emetimet GHG, duke bërë zhvillimin e inventarit kërkuar dhe të komplikuar. Proçesi i përgatitjes së inventarit të GHG është i rëndësishëm sepse përfshin shumë institucione kombëtare dhe ekspertë lokalë, dhe siguron bazë të dhënash të qëndrueshme dhe relativisht të besueshme të cilat janë të nevojshme për zhvillim dhe përmirësim të mëtejshëm³.

Prodhimi i energjisë elektrike në Serbi emeton

çdo vit rreth 35 milion ton CO₂. Burimet më domethënëse të këtyre grimcave në Serbi janë termocentralet, impiantet për prodhimin dhe përpunimin e metaleve dhe industrinë minerare. Shuma totale e emetuar e këtyre grimcave në vitin 2012 arriti në 24.52 Gg. Totali i rezervave energjitike të disponueshme përfaqësohen kryesisht nga varietetet e qymyrit (99%), kryesisht me vlerë kalorifike të ulët të linjtit. Burimet e tjera të energjisë (1%) përbëjnë rezervat e naftës dhe të gazit. Krahasuar me periudhën 1961-1990, periudha 1971-2000 ishte 0.7 °C më e ngrohtë në pjesën më të madhe të Republikës së Serbisë.

SKENARËT E ARDHSHËM MBI KLIMËN NË SERBI:

Efektet afat-gjatë të pritshme prej ndryshimeve klimatike janë:

- rritja e intensitetit dhe shtrirjes së zjarreve në pyje; ndryshim në kufijtë e llojeve pyjore relative ndaj gjerësisë dhe lartësisë gjeografike; ndryshim në shpërndarjen natyrore të llojeve pyjore;

- efektet mbi burimet ujore tregojnë një rënie të rrjedhës ujore në nivel kombëtar;
- një nivel i lartë i cënueshmërisë së prodhimit bujqësor në kushtet ekstreme të motit dhe ndryshimeve sistematike të kushteve klimatike;
- ndikimet e ndryshimeve klimatike mbi biodiversitetin dhe ekosistemet natyrore: ndryshimet fenologjike, ndryshimet në morfologjinë, fiziologjinë dhe sjelljen e specieve; humbjen e habitateve ekzistuese, ndryshimet në numrin dhe shpërndarjen e llojeve;
- Impakte në shëndetin e njeriut, një rritje në vitet e fundit të numrit të goditjeve nga nxehtësia dhe vdekshmërisë gjatë periudhave me temperatura shumë të larta ditore të ajrit.

SI DUHET TI BALLAFAQOJË SERBIA PROBLEMET E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Ballafaqimi në tërësi fillon nga një skemë e kuotave të energjisë dhe të përpjekjeve për t'iu përgjigjur sfidave ekonomike, sociale dhe mjedisore nëpërmjet tyre. Përzgjedhja e energjisë së lejuar si pikë kyçe nuk është një rastësi; shumica e problemeve tona janë të lidhura me përdorimin e energjisë.

Serbisë i duhet të forcojë mundësitë teknike, politike dhe juridike, si shtet ne kemi mbetur pas në propozimin e dokumenteve të ndryshme të rëndësishme dhe gjithashtu strategjive në lidhje me reduktimin dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Serbia në brendësi të Ministrisë së Energjitikës, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Republikës së Serbisë ka në sektorin mjedisor, Departamentin e Ndryshimeve Klimatike. Për të përmbushur detyrimet, Departamenti i Ndryshimeve Klimatike në Mjedis (sektori) koordinoi dhe ishte përgjegjës për zhvillimin fillestar të Komunikimit Kombëtar të Republikës së Serbisë në kuadër të programit të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike i cili është dorëzuar në Sekretariatën e UNFCCC në nëntor të vitit 2010.

REKOMANDIMET PËR PUNËN NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË SERBI DHE ROLI I CEKOR DHE OJQ-VE

Serbia si vend kandidat që po përpiqet të jetë anëtare e BE-së, është e detyruar të përshtasë legjislacionin e saj në përputhje me atë të BE-së, prandaj Serbia ka angazhim politik për të përshtatur dhe zbatuar legjislacionin në nënkategoritë : energji, eficienta energjitike, transporti, dhe mjedisi (në përgjithësi). Megjithatë, ekzistojnë nevoja për ngritjen e kapaciteteve të të gjithë aktorëve për të arritur aleancën, dhe këtu opsionet janë:

- Forcimi i bashkëpunimit mes sektorëve dhe miratimi i ndikimeve të ndryshimeve klimatike si prioritet i sektorëve, është një nga parakushtet kryesore për zbatim efikas dhe të plotë të vëzhgimit sistematik.
- Mbështetje për OJQ-të që do të jenë të dobishme për adaptacione të komuniteteve lokale ndaj ndryshimeve klimatike.
- Rritja e ndërgjegjësimit në media në lidhje me nevojat për përshtatjen me sfidat e ndryshimeve klimatike.
- Ngritja e kapaciteteve në fushën e analizës sistematike tekno-ekonomike të mundësisë për zbatimin e ndryshimeve klimatike dhe projektimin e skenarëve të mundshëm, për çdo sektor, dhe vlerësimin e nevojave përkatëse teknike, teknologjike dhe financiare.
- Rritjen efektive të eficientës energjetike, në të gjithë zinxhirin e përdorimit të energjisë, rritjen e mëtejshme të kapaciteteve dhe metodikës së punës, sidomos për përgatitjen e dokumenteve ndërkombëtare dhe planeve të veprimit për zbatim.
- CEKOR do të marrë pjesë në konsultim me Fondet IPA referuar ndryshimeve klimatike dhe në konsultimin për raportin e dytë të ndryshimeve klimatike.
- Në përgatitjen dhe zhvillimin e strategjive për ndryshimet klimatike në Serbi CEKOR do të bashkëpunojë me Parlamentin e cili është planifikuar të përgatitet deri në vitin 2015, sepse Parlamenti do të punojë në përgatitjen dhe zhvillimin e masave.
- Gjithashtu, CEKOR është edhe pjesëmarrës dhe udhëheqës në procesin e Konventës për Kapitullin 27, më tej ne do të bashkëpunojmë në aspektin e energjisë dhe të transportit (trafikut), duke mbuluar ndryshimet klimatike dhe zbatimin e tyre.
- Në periudhën e ardhshme ne kërkojmë për financim dhe bashkëpunim me organizatat të tjera si MTVZ në favor të zbatimit të projekteve në çështjen e ndryshimeve klimatike.

Humbje e burimeve - trajtimi jo i duhur i mbetjeve në Bosnje-Hercegovinë



Po jetojmë në një kohë ku po i afrohem i kufijve të shterimit të burimeve të caktuara natyrore, ku shfrytëzimi i tyre shpesh herë bëhet në mënyrë të pakontrolluar dhe të paplanifikuar dhe mbi të gjitha nevojat për këto burime natyrore janë cdo ditë e më shumë në rritje. Në rrethana të tilla, është e nevojshme që të gjitha vendet, duke përfshirë këtu edhe ato në zhvillim, të adresojnë seriozisht këto çështje dhe të zhvillojnë një plan për përdorimin efikas të burimeve.

Vlerësimet tregojnë se popullsia në vitin 2050 do të rritet mbi 9 miliardë banorë, ndërkohë 2 miliardë banorë nga vendet në zhvillim do të trefishojnë shpenzimet e tyre dhe sektori i biznesit do të trefishojë shfrytëzimin e burimeve të tilla si: mineralet, masa drurore, metale, lëndë djegëse nga fosilet etj. Për të penguar që parashikime të tilla të kthehen në realitet, cka do sillte pasoja fatale për planetin tonë duke ndikuar dhe në cilësinë e jetës së njerëzve, është e rëndësishme të fillojmë menjëherë me planifikimin dhe zbatimin e masave për shfrytëzimin efikas të burimeve të mbetura. Kjo i referohet veçanërisht vendeve në zhvillim, të tilla si Bosnja dhe Hercegovina, ku prirja e tanishme e konsumit është në rritje, si rezultat i zhvillimit të politikave, promovimit të konsumimit, prodhimit në masë, ofrimit të produkteve me cilësi të ulët si dhe mungesës së planeve dhe rregullave të cilat do të kufizojnë humbjen e burimeve.

Përdorimi efikas dhe i qëndrueshëm i burimeve përfshin përdorimin e qëndrueshëm të tyre në një mënyrë që të ketë efekte minimale në mjedis. Qëllimi i përdorimit efikas të burimeve është se duke përdorur më pak burime ne jemi në gjendje të krijojmë më shumë, ose për të krijuar më shumë vlera me më pak investime dhe sigurisht më pak pasoja negative për mjedisin. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve është zgjidhja e vetme që do të na lejojë ne dhe brezat e ardhshëm të arrijmë zhvillimin ekonomik dhe social me burime të kufizuara natyrore ndërkohë që mbrojmë dhe mjedisin.

Si mund të lidhet mungesa e burimeve, menaxhimi

me efikasitetin e burimeve dhe mbetjet? Aktualisht, një nga burimet më të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm janë mbetjet pasi përfaqësojnë një burim dytësor materialesh të papërpunuara dhe zëvendësojnë burimet parësore. Ekonomia e bashkimit Evropian harxhon 16 ton burime natyrore për frymë, ndërkohë kur cdo qytetar i Bashkimit Evropian prodhon rreth 6 ton mbeturina në vit. Këto të dhëna tregojnë se cdo vit një numër i madh burimesh harxhohet dhe se ka një potencial shumë të madh për ripërdorimin e burimeve të përdorura nëpërmjet menaxhimit adekuat të mbetjeve.

Parandalimi i mbetjeve, si hapi i parë në hierarkinë e mbetjeve, ka një ndikim të drejtpërdrejtë duke reduktuar nevojën për burime natyrore, duke përmirësuar sjelljen e konsumatorëve. Hapi i dytë dhe i tretë, ripërdorimi i produkteve dhe riciklimi, janë një mjet i rëndësishëm për reduktimin e përdorimit të burimeve natyrore dhe për të siguruar krijimin dhe shfrytëzimin e lëndëve të para.

Menaxhimi adekuat i mbetjeve është një potencial i madh për zhvillimin ekonomik dhe social të shoqërisë, dhe gjithashtu ka një kontribut të rëndësishëm në uljen e ndikimit në ndryshimet klimatike dhe pasojave të tjera negative në mjedis. Avokimi i parimit të efikasitetit të burimeve nëpërmjet menaxhimit të mbetjeve kontribuon në uljen e kostove të prodhimit, e cila ndihmon industrinë të jetë më e qëndrueshme dhe më efikase në punën e saj.

Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave në Bosnje Hercegovinë (BH) ende nuk e njohin kolapsin e madh të mundshëm për shkak të mungesës së një sistemi efektiv të mbledhjes së ndarë të mbeturinave dhe riciklimi.

Edhe pse ka baza ligjore që përcaktojnë se si mbetjet duhet të trajtohen (Ligji i Menaxhimit të mbeturinave të Republikës Serbe dhe Ligji Menaxhimit të Mbeturinave të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës), për shkak të dështimit të zbatimit të tyre shoqëria jonë është duke humbur burime të mëdha të cilat shkaktojnë dëme në mjedis që nuk



HIERARKIA E MBETURINAVE

PARANDALIM

Nëse ju nuk mund të parandaloni, atëhere....

PËRGATITU PËR RIPËRDORIM

Nëse ju nuk mund të përgatiteni për ripërdorim, atëhere.....

RICIKLO

Nëse ju nuk mund të ricikloni, atëhere....

KTHEJE NE NJË VLERË TJETËR (E.G. ENERGJI)

Nëse ju nuk mund të ricikloni, atëhere....

HIDHENI

Landfill nëse nuk ka alternative tjetër të diponueshme

mund të ribëhen. Trajtimi jo adekuat i mbeturinave “varros” landfillët ekzistuese dhe redukon ciklin e tyre të jetës. Kjo mënyrë e trajtimit të mbeturinave gjithashtu kërkon një nevojë për landfille të reja, të cilat për shkak të investimeve të larta që nevojiten për ndërtimin e tyre zakonisht nuk plotësojnë të gjitha kërkesat e nevojshme ekologjike. Në vitin 2002 institucionet e Bosnjes dhe Hercegovinës morën kredi nga Banka Botërore për të siguruar një pjesë të fondeve të nevojshme për ndërtimin apo rinovimin e landfillve ekzistuese⁴.

Raportet nga 2010 tregojnë se sasia e mbetjeve për frymë në Bosnje-Hercegovinë është e ngjashme me vendet e tjera të rajonit dhe nën sasinë mesatare të BE-së. Sasia e saktë e mbetjeve totale urbane në vitin 2010 ka qenë 332 kg për frymë⁵. Megjithatë, është shqetësuese që sasia e mbetjeve për frymë në Bosnje dhe Hercegovinë është në rritje dhe i njëjti trend pritet në të ardhmen si rezultat i zhvillimit të turizmit, të ekonomisë dhe si rezultat i ndryshimit të sjelljes së konsumit të qytetarëve. Plani për reduktimin e mbetjeve dhe riciklimin e tyre nuk ekziston dhe nuk ka as një tregues se një gjë e till do të mund të krijohet në një të ardhme të afërt.

Në seksionin e mëposhtëm ne do të prezantojmë metodën e menaxhimit të mbetjeve në Republikën Çeke dhe do ta krahasojmë atë me sistemin e menaxhimit të mbetjeve në Bosnje-Hercegovinë. Arsyeja për krahasimin e këtyre dy sistemeve është se në një kohë jo shumë të largët Republika Çeke u përball me të njëjtin problem që Bosnje-Hercegovina po përballat sot dhe pas një periudhe relativisht të shkurtër ata patën një progres të vlefshëm. Edhe pse menaxhimi i mbetjeve në Republikën Çeke nuk është ideali, aktivitetet e institucioneve Çeke në fushën e mbetjeve mund të shërbejnë si shembuj të praktikës së mirë për institucionet e Bosnje-Hercegovinës.

Që nga vitet '90 të shekullit të kaluar, Republika Çeke ka bërë përpertime të rëndësishme në mbledhjen e ndarë dhe riciklimin e mbetjeve. Sot, përqindja e mbetjeve që riciklohen është rreth 25% (kjo shifër përfshin dhe kompostimin e mbetjeve organike). Raporti i riciklimit ndryshon nga një komunitet në tjetrin dhe është zakonisht më i lartë në komunitetet më të vogla krahasuar me raportin e komuniteteve më të mëdha. Edhe pse statistikat e BE-së tregojnë se në dy vitet e fundit shuma vjetore

e gjenerimit të mbetjeve për banor në Republikën Çeke është në rritje (në vitin 2001 mbetjetet ishin 273 kg për frymë ndërsa vitin 2010 ishin 317 kg për frymë), më i rëndësishëm dhe pozitiv është fakti që raporti i mbetjeve që riciklohen është rritur nga 1% deri në 16% në të njëjtën periudhë⁶. Duke krahasuar të dhënat e treguara në grafikun më poshtë që i referohet mbetjeve të prodhuara në total në Bosnje-Hercegovinë dhe Republikën Çeke dhe duke u bazuar në faktin se raporti i mbetjeve që riciklohen në Bosnje-Hercegovinë është 0%, kjo është e qartë se cili sistem menaxhimi i mbetjeve është më efikas.

Është e rëndësishme të theksohet se disa lloje të caktuara mbetjesh në Bosnje-Hercegovinë janë të riciklueshme si: (letra dhe metalet) megjithatë nuk ka shifra zyrtare për to dhe përqindja është shumë e vogël. Riciklimi i këtyre mbeturinave është bërë nga kompani private, të cilat në bazë të marrëveshjeve me individë apo kompani të ndryshme, mbledhin këto lloje mbetjesh. Aktivitetet që kanë kontribuar në mënyrë që Republika Çeke të arrijë një rritje të madhe në riciklim në një periudhë të shkurtër kohe, lidhen me kompesimin e qytetarëve për trajtimin e mbetjeve si dhe me zbatimin e direktivave të BE-së për paketimin e mbetjeve. Në shumë qytete ende punohet me sistemin e vjetër i cili përfshin një tarifë fikse mujore për çdo familje, por një numër i caktuar qytetesh të vogla punon me sistemin ku pagesa kryhet në përputhje me sasinë e mbetjeve të gjeneruara në një familje. Sistemet më të zakonshme janë: (a) "sistemi me qese", (b) "sistemi qese me kod EAN" dhe (c) sistemi PAYT (paguaj aq sa ti gjeneron (ose hedh)

a) Sistemi qese është një sistem që mbledh mbetjet shtëpiake (mbetjet urbane) në qese të veçanta ose kontenierë për secilin lloj të mbetjeve. Në varësi të llojit të mbetjeve që grumbullohen, familjet kanë qese të veçanta ose kontenierë për: letër, plastikë, metale, qelq, kartona, etj.

b) Sistemi qese me kod EAN vepron në të njëjtin parim, me përjashtimin që çdo familje ka kodin e vet EAN. Duke lexuar kodin EAN, në kohën kur mbetjet janë grumbulluar, është e mundur të matet sasia e tyre që është krijuar në një familje në një kohë të caktuar dhe mbi këtë bazë është e mundur të llogaritet se sa duhet të paguajë familja për këtë sasi të gjeneruar. Gjithashtu Kodi EAN mundëson krahasimin e prodhimit të mbetjeve ndërmjet familjeve. Të dhënat që tregojnë efikasitetin e këtyre sistemeve janë: mbi 50 % e mbetjeve riciklohen në

qytetin Olomouc, Semily dhe Svitavy. Gjithashtu, sasia e mbeturinave jo të riciklueshme për frymë në këto qytete është reduktuar dhe kjo është rreth 180 kg, ndërsa mesatarja e Republikës Çeke në 2011 ishte 292.3 kg. Këto sisteme janë të njohura kryesisht në komunitete të vogla.

c) Sistemi PAYT është një sistem që trajton mbetjet urbane të cilat nuk mund të ndahen dhe të riciklohen (mbetjet të përziera). Sipas këtij sistemi çdo familje paguan njësoj për mbetjet e përziera që ata kanë prodhuar. Zbatimi i sistemit PAYT në qytetet Hustopeče nad Bečvou i Rozsochy ka ulur ndjeshëm sasinë e mbeturinave të përziera dhe tani është më pak se 100 kg për frymë. Aktualisht pak më pak se 15 % e qyteteve në Republikën Çeke përdorin sistemin PAYT dhe kjo përqindje është duke u rritur për çdo vit⁷. Sisteme të tilla mund të aplikohen jo vetëm në komunitete të vogla. Shembull i vërtetë është Praga ku ka mbi 3000 kontenierë për mbledhjen selektive të mbetjeve, 14 oborre grumbulluese dhe 280 dyqane grumbullojnë mbeturina elektronike. Në vitet e fundit, në shumë familje dhe blloqe apartamentesh bëhet riciklimi i mbetjeve organike, kompostimi. Kompanitë komunale ose autoritetet lokale ofrojnë kosha kompostimi për shtëpitë, ndërtesat ose ata ndërtojnë fusha kompostimi në nivel të komuniteteve lokale. Prej nga koha kur mbetjet bio përbëjnë një të tretat e mbeturinave totale të familjes, kompostimi do të kontribuojë në mënyrë të ndjeshme në uljen e sasisë së përgjithëshme të mbetjeve. Republika Çeke nuk mund të mburret me rezultatet e mira sepse vetem 2% e bio-mbetjeve është e kompostueshme⁸. Zbatimi i sistemit të kompostimit ka një potencial të madh dhe do të jetë një sfidë e madhe në të ardhmen për Republikën Çeke.

Më e rëndësishmja në zbatimin e një sistemi të tillë të grumbullimit të mbetjeve është pasqyruar jo vetëm në faktin se njerëzit kanë filluar në masë të madhe të ndajnë mbetjet, por në faktin se këto sisteme inkurajojnë në zvogëlimin e krijimit të mbetjeve. Respektimi i hierarkisë së mbetjeve, që përbën dhe qëllimin më të rëndësishëm, krijon më pak mbetje dhe zvogëlohet nevoja për të ricikluar, zvogëlohen problemet e hedhjes së mbetjeve dhe reduktohet shkatërrimi i burimeve natyrore. Nëse krahasojmë sistemin e pagesave për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve urbane në BH, i cili është i ngjashëm me sistemin e vjetër në Republikën Çeke, me sistemet e shpjguara më sipër, fakti tregon që sistemi në Bosnje dhe Hercegovinë nuk i

inkurajon njerëzit të prodhojnë më pak mbeturina. Ndërgjegjësimi i qytetarëve në BH për pasuritë që fshihen në mbetjet e prodhuara është zhvilluar dobët. Për të bërë një hap përpara dhe për të minimizuar sasinë e burimeve të shkatërruara pa nevojë, ne na duhet një sistem që do të inkurajojë njerëzit të mendojnë për nevojën për të ruajtur burimet natyrore duke ulur gjenerimin e mbetjeve. Nëse grumbullimi i ndarë dhe riciklimi i mbetjeve do të menaxhohen nga kompani private apo publike, është pak e rëndësishme. Në këtë moment në Bosnje-Hercegovinë në terma të zhvillimit ekonomik dhe

social, si dhe të ruajtjes së burimeve dhe mbrojtjes së mjedisit, është thelbësore për të krijuar një qasje serioze të planifikimit për menaxhimin e mbetjeve dhe që menjëherë të fillojë zbatimin e saj. Shembuj të praktikave të mira janë kudo rreth nesh, ato vetëm duhet të zbatohen dhe të bëhen të mundura.

REFERENCA

1. http://www.mtvsh.hu/dynamic/klima_angol_01.pdf
2. <http://www.merz.gov.rs/en/odsek/climate-change-division-environment>
3. <http://www.merz.gov.rs/en/dokumenti/initial-national-communication-republic-serbia-under-united-nations-framework-convention>
4. Raporti i OJF-ve në lidhje me procesin e ndërtimeve të landfillleve rajonale në Bosnje-Hercegovinë
5. Raporte të kushteve mjedisore në Bosnje-Hercegovinë në 2012. Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Mardhënieve Ekonomike të Bosnje-Hercegovinës
6. Menaxhimi i Mbetjeve Urbane në Republikën Ceke, Agjenisa Evropiane e Mjedisit, Shkurt 2013
7. Udhërrëfyesi për Republikën Ceke
8. Menaxhimi i mbetjeve në Europën Qendrore dhe Lindore, C'MS



CEE Bankwatch Network
Na Rozcestí 1434/6
Praha 9, 190 00
Czech Republic
E-mail: main@bankwatch.org
Web: bankwatch.org
Twitter: [@ceebankwatch](https://twitter.com/ceebankwatch)
Facebook: facebook.com/ceebankwatch